



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 710/Prot  
2

Tiranë më 11.02.2020

**VENDIM**

Nr. 9 datë 11.02 2020

**“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË ZËRAVE TË BUXHETIT PËR VITIN 2020”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38 pika 1 gërma h, Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar me Urdhërin e MASR Nr. 816 datë 26.12.2018, neni 31 gërma o; Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 88/2019 datë 18.12.2019 “ Për buxhetin e vitit 2020” , Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, deri në miratimin e buxhetit të konsoliduar për vitin 2020, sipas kërkesës së Administratorit të UT-së, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 11.02.2020;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë paraprakisht zërat e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2020 “Ditët e informimit të maturantëve , shpenzime në kuadrin e projektit Interba për shumën totale 850.000 lekë me tvsh”
2. Të miratojë paraprakisht fondin për pagesën e pajisjes me numër matrikullimi për studentët e vitit të parë të ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve në shumën 100lekë/student, të cilat do të përballohen nga të ardhurat e buxhetit të UT-së.
3. Ky vendim t’i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të Universitetit Tiranë.

KRYETARI  
PROF. DR. MËNYR KONI

